

VENDIM
Nr.70, datë 10.12.2007

**PËR SHQYRTIMIN E TRANSFERIMIT TË LICENCËS NGA SHOQËRIA “ESSEGEI SHQIPËRI
SMOKTHINA” SHPK TE SHOQËRIA “ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.445, datë 17.6.2001 “Për miratimin e kontratës koncensionare të formës ROT ndërmjet Ministrisë Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë italiane “Essegei” s.r.l për HEC-in e Smokthinës”, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 “Rregullore e procedurave të licencimit” neni 12, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.15, datë 27.8.2003, pikat 1.3 dhe 1.4 të kushteve të licencës, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 7.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. për transferimin e licencës së dhënë nga ERE shoqërisë “Essegei Shqipëri Smokthina” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Licenca me nr.05, seria PO3K, datë 27.8.2003, dhënë shoqërisë “Essegei Shqipëri Smokthina” sh.p.k. t’i transferohet shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k.

2. Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. mbart të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në licencën e prodhimit të energjisë elektrike nr.05, seria PO3K, datë 27.8.2003, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.15, datë 27.8.2003.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta